

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit, anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtaret Beqir Kalludra dhe Lumnije Krasniqi me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit Z.K. për shkak të veprës penale: Cenimi i përcaktimit të votuesëve nga neni 177 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.23-14/2011, të dt: 28.03.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik me dt: **14.06.2016**, të njëjtën ditë bjenë në prezencën e të akuzuarit Z.K. dhe mbrojtësit av.B.K., publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

Z. K., nga i ati N., e ëma M. e gjinisë H. i lindur me dt. *data e lindjes...*, në f.sh “N.”, KK-“D.”, ku dhe tani jeto, me nr. personal: *numër personal...*, pjestar i FSK-së, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë jo i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet ndojë procedurë për ndonjë vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

LIROHET NGA AKUZA

SE: I pandehuri Z. K. me datën 12.12.2010 reh orës 07:00 deri në orën 19:00 në qendër të votimit 0314e/02D dhe 0314e/02R, në shkollën fillore “Jusuf G ërvalla” që gjendet në fashin N. KK.G., I pandehuri Z. K. me përdorimin e dhunës dhe kanosjes, ka ndikuar në votuesit e qendrave ,të lartë cekura ,duke I orientuar qytetarët të cilët kishin dalë ,për të votuar,në këto qendra të lartë cekura,në ate menyrë që të njejtit,I orientonte që nga hyrja e deri te vend votimi që të votojn

-me çka kishte për të kryer veprën penale: Cenimi i përcaktimit të votuesëve nga neni 177 të KPK-së .

Andaj gjykata në kuptim të nenit 364 par.1 nën.par.1.3 të KPPK-së,

Ndaj të akuzuarit **Z. K.**

Për veprën penale Cenimi i përcaktimit të votuesëve nga neni 177 të KPK-së merr **AKTGJYKIM LIRUES**, sepse nuk është provuar se i akuzuari Z. K. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale, mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Ish Prokuroriia Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ngritë aktakuzë PP.nr.23-14/2011 të dt: 28.03.2011 kundër të akuzuarve: V.Sh.,V.Q.,R.Sh.,S.Z.,A.Sh.,V.G.,H.Sh. dhe Z.K.per shkak të veprës penale Mashtimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Me aktgjykimin e gjykates se Qarkut në Prishtinë AP.nr.42/11 të dates: 08.06.2012 me miratimin e ankeses se Prokurorot Publik Komunalë në Prsihtinë është ndryshuar aktykimi i gjykates në Glllogovc P.nr.162/2011 datë 27.05.2022 ndaj të akuzuarve V. Sh.,V. Q., R. Sh., S. Z., A. Sh., V.G.,dhe H. Sh. përkitazi me vendimin për denim, ashtu që Gjykata e Qarkut në Prsihtinë ndaj të akuzuarve per vepren penale të mashtrimit në votime për të cilën janë shpallë fajtor, i gjykon secilin me nga 6 (gjashtë) muaj burgim, ndersa për të akuzuarin Z. K. lënda është kthyer në rigjykim.

Duke vepruar siaps sygjjerimeve të Gjykatës se Qarkut në Prsihtinë, Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti i krimeve te renda, ka caktuar shqyrtimni gjyqsor, ku në seancen e shqyrtimit gjyqësorë pas leximit të aktakuzës, me rastin e deklarimit të të akuzuarit lidhur me qështjen e fajsisë në kuptim të nenit 326 parg 1 të KPPRK-së, i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajsisnë, dhe duke qenë se I akuzuari nuk e ka pranuar fajsinë për aktakuzën në fjalë, gjykata duke u bazuar në nenin 327 parg 1 nënparg 1.2 të KPPRK-së, ka vendosë që séance e shqyrtimit gjyqësorë të vazhdoj me prezentimin e provave.

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, përfaqësuesja e aktakuzës Ferdane Sylejamni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë është vërtetuar dispozitivi i aktakuzës se ngritur kundër të akuzuarit për vepren penale për të cilën akuzohet. Në baze të provave materjale që janë administruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore, vlerësoj se i njeiti është përgjegjës penalisht për shkak të veprës së kryer penale. I propozon gjykates që për vepren penale cenimi përcaktimit të votuesëve nga neni 177 të KPK-së të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit.

Mbrojtési i të akuzuarit Z.K. av.B. K. ne forme te shkruar gjykatës ja ka prezentuar fjalën perfundimtare dhe ne pikat te shkurta te njeten e ka elaboruar,duke theksuar se deshmitaërt e degjuar prane gjykatës ne deklarimet e tyre nuk kanë thene se e kanë e parë Z. K. duke ndikuar tek votusit, qofte per mes kercnimit, apo detyrimit qe te votjnë për ndonje subjekt politik. Ata bile në ditën e votimit nuk kishin vrejturë ansnje parregullsi lidhur me këtë rast, as qe kishte raportuar dikush tek komisionert, se Z. K. ka kercnuar, apo detyruar dikend që të votojnë, ose mos votojnë dhe këtë nuk e thane as deshmitarë të cilet kishin bërë kallzimni penal tek policia. Deshmitart e ndigjar në shqyrtimin gjyqsor E. K. dhe P. B., nuk kan arritë ta vërtetojn faktin se a ka pas kercnim te votusve nga ana e Z. K., as këta vete nuk kishin qene të kërcnuar nga Z. , sepse deshmitari E. K. disa herë pas parashtrimit te pyetjeve nga ana e mbrojtsve ka deklaruar se nuk ka qene i ndikuar nga Z.K., ndersa deshmitari P.B. si pergjegjjes i shtabit zgjedhor në Drenas për subjektin LVV, ka theksuar deri sa ka pritut telefonata nga komisioneret, vetem ka marre një telefonat nga vëzhguesi E. K. lidhur me kinse me qendrimin e të akuzuarit Z. K. në

lokalin ku nuk duhet të rrinë personat pa autorizime dhe po aashtu ka theksuar se nuk kishte marr asnjë ankesë tjetër nga ndonjë qytetar se ka ndikuar tek ata lidhur me votimin ,apo jo të ndonjë subjekt politik. Për keto arsye në fund i ka propozuar gjykates që ne munges të provave të njetin ta liron nga aktakuza.

I akuzuari Z. K. në tërsi e përkrahe fjalën përfundimtare të mbrojtësëve , duke shtuar se vetën e konsideron të pafajshëm dhe kërkon që gjykata ta e lironë nga përgjesija penale.

Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë në të cilën u administruan të gjitha provat materjale, të njejtat i vlerësoi veç e veç dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, e vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të deklaratave të deshmitarve M. Sh., H. K., F. Sh., I. K., A. Sh., S. K., B. K., H. K., E. K., P. B., me leximin e libes së votimit për vend votimin 0314E /02D dhe ne fund e ka ndegjaur të akuzuarin Z. K. dhe deklarimin e tij e ka marr si prove.

E ndigjuar ne cilësinë e deshmitarit në shqyrtimin gjyqësorë M. Sh. ka deklaruar, se: Diten e votimit ka punuar si anëtare e komisionit tek vula dhe ka vërejtur se Z. K. ka qendruar në momentin ku u ba hapja dhe mbyllja e vendvotimeve duke thekësuar se se i njejtë ka hyre ne dhomen e numerimit 0314E -01 dhe ka ndihmuar në numerimin e votave, mirëpo nuk e di se a ka pas të drejtë a po jo, i njejtë me i ndihmue në numerimin e votive. Sa e dinë , nuk ka pasur vërejtje në sjelljen e Z. K. nga askush, sepse zakonisht vërejtjet paraqiten tek kryesuesi i komisionit. Në pyetjen e parashtruar nga i akuzuari ka deklaruar se e dinë se janë dy Z. me të njejtën mbiemër- K.. Z. ka qenë kryesuesi i komisionit, ndersa i akuzuari duke qenë prezent ju ka ndihmuar personave në numerimin e votive dhe ka shtuar se nuk e ka ngatrruar me personin tjetër me të njejtin emer dhe mbiemrin, dhe se e dinë rolin e të dyve.

I ndegjuar në cilësin e deshmitarit H.K. ka deklaruar se ditën e zgjedhjeve ka qenë anëtarë i komisionit për të cilën ka qenë i trajnuar dhe ka punuar tek kutia e votimit. E ka pa të akuzuarin Z. K. kur ka ardhur me votue , e ka verejtë në koridorë dhe ka thekësuar se personalisht nuk e ka pa të njejtin që ka ndikue në ndonji person tjetër gjatë votimit , as nuk ka ndigjue që dikush nga anëtarët e komisionit kanë pasur vërejtje në të akuzuarin .

I ndëgjuar në cilësinë e dëshmitarit F. Sh. ka deklaruar se me dt: 12.12.2010 ka votue në shkollën fillore “Jusuf Gërvalla“ dhe ka dhënë një deklaratë në lidhje me prindin që ka qenë I vdekur dhe me arsyetue pse dikush ka votue në emrin e tij , meqe deshmitari atë ditë ka votuar vetëm në emrin e vet. Ka shtuar se Z. K. e njeh shumë mirë, është vendasi I tij dhe ka respekt të veçant për te. Diten kritike Z. K. nuk e ka parë. Gjatë votimit nuk ka vërejtë ndonji parregullësi dhe pasi që ka përfunduar votimi është larguar nga ai vend.

I ndëgjuar në cilësinë e dëshmitarit I. K. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se ditën e zgjedhjeve ka votuar në shkollën fillore Jusuf Gërvalla në fshatin N., Ka qenë anëtar i komisionit zgjedhorë dhe ka qenë i ngarkuar me libren e votuesëve, por i ka kryer edhe punët të tjera duke i ndihmuar kolegëve gjatë kontrollimit të rreshtit dhe punës me sprei . Ka qenë i trajnuar për procedurën e votimit dhe ka shtuar se deri sa ka qenë tek libri i votuesëve nuk ka vërejtë se dikush prej personave ka votuar dhe përsëri është kthyer për të votuar për herë të dytë , sepse secili gjatë votimit e ka prezentuar letërnjoftimin dhe pas verifikimit në regjistër e kanë kryer obligimin e votimit . Nuk ka vërejtë se i akuzuari Z. K. është kthyer prapë, për të votuar për herë të dytë dhe në seancën gjyqësore ka sqaruar se Z. paraprakisht e ka kryer obligimin e vet për të votuar dhe në momentin kur ka ardhur së bashku me prindët, komisioni nuk i ka lejuar me hy më prindët e kanë sugjeruar verbalisht por asnjë vërejtje nuk është shënuar në procesverbal në lidhje më zhvillimin e procesit së votimit.

I ndëgjuar në cilësinë e dëshmitarit A. Sh. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se ka qenë vetëm votues, nuk kam qenë antarë i komisionit për zgjedhje. Zakonisht voton në mengjez kur nuk ka shumë njëerëz. Atë ditë ka shkuar me familjen e tij ku secili ka votue ndaras, në kabinë . Z. K. e një prej shkollës fillore, si figurë dhe për të njëjtin ka theksuar se është djali i mirë dhe i urtë. Nuk i kujtohet se atë ditë që e ka parë të akuzuarin Z. K.. Për qyshen e tij të ndjerë Sh. Sh. as ajo e as familja e tij nuk kanë votuar .

I ndëgjuar në cilësinë e dëshmitarit S. K. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se ka qenë i obliguar me e hapë shkollën fillore në orra 6 të mengjezit , ndersa në orra 7 të mengjezit është hapur qendra e votimit . Si menaxher e ka pasur për detyrë me e informue KQZ-në se në orra sa ka filluar votimi dhe a është gjithshka në rregull. Në orra 11 është dashtë që të raportohet sa votues kanë dal me votue me përqindje , por edhe me numra , e poashtu kur ka përfunduar puna në qendren e votimit kanë raportuar që është mbull me kohë se bashku me numrin e personavë që janë dal në zgjedhje. Me dt. 12.12.2010 ka qenë i obliguar me e vëzhgue situatën në koridorin e shkollës për shkak mos me e ndodhë ndonji paregullësi gjatë votimit . Gjatë votimit asnjeherë nuk ka ndodhë, e as nuk ka ndonji informatë se ka ardhur deri në ndonji paregullësi gjatë procesit të votimit. Dëshmitari ka shtuar se nuk e posedon asnjë informacion që i akuzuari Z.K. ka bërë ndonji paregullësi ditën e votimit. Të njëjtin e ka pa kur ka ardhur me familjen e tij, me nënën dhe gjyshen dhe e ka kryer obligimin si qytetarë, ka votue dhe ka dal jashta objektit të shkollës. Në qendren e votimit, saktësisht në dhomen e votimeve nuk ka pasur të drejtë me hy, vetëm në rastet kur ftohet për ndonjë parregullësi. Në rastin konkret askush nga anëtarët e Komisionit nuk e kanë ftuar dhe nuk ka qenë i informuar për asnjë parregullësi gjatë procesit të votimit. Poashtu ka deklaruar se nuk ka marrë pjesë në numrimin e votive, duke marrë parasysh se detyra e tij as nuk ka qenë ajo. Për të akuzuarin Z. K. ka theksuar se i njëjti nuk ka qenë anëtar i Komisionit, për anëtarët e Komisionit saktë me emra nuk e din se kush ishin, por e din që në mesin e anëtarëve të Komisionit nuk ka figuruar emri i Z. K.. Për personin e quajtur M. Sh. ka deklaruar se e

njeh, dhe e njeta nuk ka ardhur dhe nuk e ka njoftuar për ndonje parregullësi eventuale brënda, ne vendin e votimeve dhe për këtë arsëye deshmitari ka raportuar se votimi ka përfunduar ne mënyre të rregullt dhe nuk ka pasur asnje parregullesi. Me rastin e arrdhjes se policisë dhe marrjen e kutive te votimit dhe dërgimin e tyre ne KQZ, deshmitari nuk e ka pasur asnjë obligim tjetër pos me mbyll shkollen ne te cilën është berë edhe numrimi i votive.

Deshmitari B. K., ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ne ditën e votimit ka qenë vezhgues ne dhomën e votimit ku ka qene e vendosur shkronja A-N.Për te akuzuarin Z. K. ka theksuar se I njejt i nuk ka qenë antarë I komsionit, as nuk e ka parë ne dhomen ku ka punuar si vezhgues per subjektin e PDK-se.Policia ka qene prezente ne shkollen ku ka qenë duke u zhvilluar procesi i votimit nga ora 5 (pesë) te mëngjesit, nga koha kur edhe janë sjelle kutitë e votimit, se bashku më fletëvotimet. Fillimitsht policia ka bërë kontrollimin e shkollës dhe vendosjen e kutive të votimit se bashku me fletëvotimet nëpër klasa, ku pastaj kanë hyrë anëtarët e Komisionit dhe ne fund vezhguesit. Anetarët e Komisionit e kanë pasur për obligim të vendosin ne trupin e tyre, bexhin dhe emrin e subjektit ku kanë qenë të caktuar apo nga ana e KQZ-së.I akuzuari Z. K. nuk ka qenë antarë, as vezhgues i Komisionit ne ditën e votimit, sepse vezhguesit nuk kanë pasur të drejte të dalin nga dhoma e vitimit derisa te përfundon votimi. Duke marre parasysh se për procesin e votimin ka qenë i trajnuar se nese ndodh ndonje aksesë menjeherë ndërprehet votimit, mbyllet qendra e vitmit, njoftohet KQZ-ja dhe personat qe e shkaktojnë ndonji parregullesi, nga ana e policisë personi mbahet ne mbajtje derisa te përfundon votimi, dhe pastaj vazhdohet me procedurat te tjera. Ne rastin konkret ne ditën e votimit nuk ka pasur asnjë parregullësi, si vëzhgues I partisë , mirëpo as nga OJQ, nuk e kanë pranuar ndonjë njoftim qe ka ardhur deri tek ndonjë parregullësi gjatë procesit të votimit . Për te akuzuarin Z. K. ka shtuar se e njeh, mirëpo ne fshatin N. ka disa persona me emer dhe mbiemer te njejt sikurse Z.K..

I dëgjuar ne deshmin e deshmitarit H. K. ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën e votimit ka qenë vezhgues me dhomen me shkronjen N-ZH, dhe Z. K. sikurse edhe te gjithë qytetarët ka ardhur për te kryer obligimin qytetar, ka votuar dhe ka dalur nga qendra e votimit. E dinë qe ka qenë i shoqeruar me dike por tani nuk I kujtohet me kend, sepse ka kaluar një kohë e gjatë.Ne lidhje me te akuzuarin Z. nuk ka marrë asnje njoftim se I njejt i ka prishur rrendin ne qendren e votimit, dhe nuk ka qenë I njoftuar se Z. ka berë ndonjë parregullesi ne qendren e votimit. Edhe ky deshmitar ka deklaruar se ne fshatin N. ka persona me emër dhe mbiemer, sikurse Z. K. dhe personalisht e njeh te akuzuarin Z. K..

I dëgjuar ne cilësin e deshmitarit E. K. në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se në ditën e votimit ka punuar dhe detyra e tij ka qenë me e dërgue ushqimin personave që kanë punuar si monitoruesit për vetëvendosje dhe mi i ndihmue nese paraqitet nevoja edhe për ndonji punë tjetër. Atë ditë ka shkuar në orra 10 , mirpo ka bërë levizje. Nuk ka poseduar bexhin, por ka pasyr edhe persona të tjerë që nuk kanë poseduar bexhin , nuk

kanë punuar por vetëm kanë qendru mbrenda në shkollë , por jo në qendren e votimit, kanë qendruar nëpër koridore. Diten e votimit është takuar me të akuzuarin Z. K. dhe ka zhvilluar bisedën me të në lidhje me procesin e votimit ku i njëjti nuk e ka përdorë ndonji fjalë që manifestohet me kanosje serioze dhe nuk ka qenë kërcnimi i drejtëpërdrejtë të mos votojë, apo të votojë. Z. K. e njëj sepse motra e tij ka qenë një gjeneratë me të, dhe për të njëjtin ka thënë se është bashkëluftetarë i vëllaut. Edhe pse rastin e ka paraqitur në polici si kërcnimë , sot nuk e ndinë vetën të kërcnuar, as si të demtuar.

Dëshmitari P. B. në shyrtime gjyqësore ka deklaruar se ka qenë shef i shtabit zgjedhor i subjektit politik LVV, kryetar dege dhe në vazhdimësi ka qenë në kontakt me komisionerët dhe vëzhguesit në qendrën e votimit. Ka deklaruar se E. K. është ankuar se i akuzuari Z. K. ka ushtruar presion ndaj votuesëve, vëzhguesëve, komisionarëve duke i orientuar votuesit për të votuar për subjektet e caktuara. Informata për parregullësinë e ka pranuar përmes thirrjes telefonike nga E. K., dhe me sa i kujtohet informata e vëzhguesit lidhet për personin , tani të akuzuar Z.K. I cili është parë në objektet ku nuk ishte i lejuar qëndrimi i tij, në vendin ku vetëm personat të cilët e kanë autorizimin mund të qëndrojnë në lokale dhe dhoma në të cilat zhvillohet procesi zgjedhor duke poseduar bexhat e siguruar nga KQZ-ja.Për E. K. nuk e ka ditur se a e posedon , apo jo bexhin por në listën e vëzhguesëve i njëjti ka qenë si staf rezervë. Përpos informacionit përmes telefonit ndonje prove konkrete nuk ka poseduar, por është inqizuar biseda por telefoni është marrë nga personat të cilët e kanë shoqëruar Z. K., dhe telefoni është thyer, gjirimet e telefonit janë fshirë, mirëpo ka mbetur informata lidhur me keqpërdorimin e procesit të votimit. Duke marrë parasysh se E. K. ka qenë në listën rezervë në rastet kur personi nga lista e rezervës e zvendos dikë tjetër atëherë ai person automatikisht paiset me bexhin dhe aty për aty e merr autorizimin si vëzhgues. Dëshmitari ka shtuar se edhe keqpërdorimin e dhomes 03-14E-1 V. Sh. nga LDD-ja, është raportuar edhe KQZ-ja saktësisht Paneli për ankesa dhe parashtrës është njoftuar për parregullësitë e procesit zgjedhor.

Duke bërë veshtrim në vletëvotimin me numër 0314E/02D nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shihet se në faqen 15/34 me radhë në rubrikën ku janë shenimet personale për të akuzuarin Z. K. i lindur me datën *data e lindjes...* me numër personal numër personal, pas verifikimit të shënimeve personale afër egziston edhe nënshkrimi i tij .

I akuzuari Z.K. nuk e ka pranuar kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë dhe në mbrojtjen e tij ka theksuar se: ditën e votimit diku pas orës 16:00 ka shkuar në shkollën fillore në N., me nënën dhe gjyshen dhe kanë votuar. I kujtohet se ka pasur shumë votues dhe është dashur të të pres, ka pasur edhe veshtersi në verifikimin e emrave , në bazë të listës për votim. Atë ditë ka qendruar në oborrin e shkollës së bashku me personat e tjerë për të kryer obligimin qytetarë. Atë ditë nuk ka qenë i caktuar si vëzhgues, as nuk ka qenë antarë i ndonje subjekti politik, sepse ka qenë në TMK, pastaj në FSK, ku nuk ju lejohet me qene anëtar i ndonje partie. Nuk është e vërtetë se gjatë qëndrimit në oborrin e shkollës i ka orientuar dhe sygjeruar qytetarët që të votojnë për subjektin politik- PDK.

Për personin E. K. ka thënë se për herë të parë e ka parë ditën e zgjedhjes dhe I njejtë ju ka afruar pasi që me vllaun e E. kanë qenë në UCK, dhe për të njetin kanë respekt dhe ka dëgjuar se ka qenë ushtarë I mirë dhe I kujtohet se I njejtë ka shpreh paknaqësi për vëllaun, sepse nuk ka qenë I punësuar edhe pse ka qenë ushtar I UCK-së. Me E. K. është takuar në oborrin e shkollës kur ka qenë duke pritur për të votuar dhe me të njetin nuk ka pasur asnjë problem. Për E. K., ka kuptuar se i njetë me vonë ka pasur problem dhe mosmarreveshje me personat e tjetër për të cilën gjë ka kuptuar me vonë, I akuzuari ka theksuar nuk është e vërtetuar se ditën e zgjedhjes e ka kërcënuar dike, sepse pasi që e ka kryer obligimin e tij si qytetar ka shkuar në shtëpi, me nënen dhe gjyshen e tij. Për personat M. Sh. dhe H. K. ka thënë se janë bashkëfshataret e tij dhe kanë qenë prezent ditën e votimit. Derisa ka qëndruar në korridor nuk e ka vërejt se ai ka biseduar me telefon me dike as nuk e di se dikush ia ka marrë E. në telefon. Sipas mendimit të akuzuarit kjo fletëparqitje është bërë me qëllim për të dëmtuar dhe rrezikuar vendin e punës dhe krejtë kjo nga xhelozia, sepse P. B. ka qenë në TMK dhe për shkak të sjelljeve të tij jo të mira e kanë larguar nga TMK-ja, dhe ka vërejtuar se pas largimit të tij nga TMK-ja i njëjtë ka shprehur një urrejtje ndaj të akuzuarit dhe me vonë ka kuptuar se P. B. ka qenë i përcaktuar për subjektin politik të VV. Të njetin nuk e ka parë ditën e votimit por për herë të parë e ka parë në procesin gjyqësor në Drenas. Në ditën e votimit ka qenë prezent patrulla e policisë ku është zhvilluar procesi zgjedhor, ndërsa brenda kanë qenë prezent dy policë, në korridorin e shkollës. Ka theksuar se në fshatin N. ka shumë persona me emër dhe mbiemër të njëjtë, sikurse I akuzuari Z. K., edhe atë ditë kryesuesi I komisionit ka qenë Z.K. sepse të njetin e ka parë duke hyrë në dhomen e identifikimit të votuesve. Ai person përafësisht I ka 50 vjet. Në fund ka deklaruar se në asnjë moment nuk ka hyrë, apo qëndruar në pjesën që nuk ka qenë e lejuar dhe asnjëherë nuk e ka orientuar dikë apo qytetaret për të votuar për subjektet e PDK-se, përpos që I ka ndihmuar nënës dhe gjyshes të cilat nuk dinë shkrim dhe lexim, por në prezencën e stafit të Komisionit të cilit ju kanë dhënë udhëzime se si duhet votuar.

Gjykata nuk ju dha besimin deklaratës të deshmities M. Sh., sepse vet deklarimi I saj është kontradiktore në pjesën kur theksoj se nuk ka pasur vërejtje në sjellje të akuzuarit Z. K., sepse ato paraqiten tek kryesuesi i komisionit. Edhe për pjesën ku ka deklaruar se i akuzuari Z. K. duke hyrë në dhomën 0314E-01 ju ka ndihmuar në numrimin e votive, por nuk ka ditur a ka pasur të drejtë, apo jo me qenë mbrenda.

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmities H. K., sepse me të njetin është vërtetuar se i akuzuari Z. K. ka qëndruar në korridorin e shkollës, mirpo në asnjë moment nuk e ka pa të njetin që ka ndikuar të ndonji person për konë më votue, por as nga antarë të komisionit nuk ka pasur ndonji vërejtje për sjelljen e tij.

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmities F. Sh., sepse me të njetin është vërtetuar se të akuzuarin Z. K. e njeh mirë, atë ditë kur është zhvilluar procesi I votimit nuk e ka parë, por nuk ka pasur asnjë paragullësi dhe pasi që është përfunduar votimi u larguar nga shkolla ku është majtë zgjedhja.

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit I. K. sepse me atë është vërtetuar se I njejtë si anëtarë I komisionit ka qenë i ngarkuar me librin e votimit , nuk ka vërejtë se dikush prej personave përseri është kthye për të votuar për herë të dytë , sepse gjatë votimit pas prezentimit të letërnjoftimit dhe verifikimit në regjistrin atëheer qytetari e kryen obligimin e vetë. Edhe për të akuzuarin Z. K. është verëtuar se I njejtë nuk është kthyer për të votuar për herë të dytë , përpos me rastin kur ka hyrë nëna e tij për të votuar nuk I kanë lejuar me shoqëru mbrenda , e kanë sugjeruar , por aja askund nuk është shënuar si vërerëte, sepse as nuk ka qenë vërejtje nga ana e vëzhguesëve.

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit S. K., sepse me atë është vërtetuar se aj si menaxher ka pas për obligim me e informue KQZ-n kur fillon votimi dhe si po zhvillohet procedura e votimit , meqenëse e ka përcjell edhe gjendjen në koridorin e shkollës . Gjatë procesit të votimit nuk ka ndodh ndonji parregullësi dhe nuk e posedon ndonji informatë që i akuzuari Z. K. në ndonji mënyrë e ka penguar procesin e zgjedhjeve. As anëtarë te komisionit nuk e kanë informuar për asnji parregullësi gjatë procesit të votimit që i njejtë ka penguar, apo ka ndikuar të ndonji qytetarë për të votuar për subjektin e caktuar politik. Në dhomen e votimeve nuk guxon me hy askush, me perjashtim te rastit kur personi ftohet për ndonji parregullësi , e që në rastin konkret nuk është i ftuar i akuzuari , sepse tek I njejtë nuk është evidentuar asnji parregullësi . Poashtu me deklarimin e tij është vërtetuar se anëtarja e komisionit M. Sh. nuk ka ardhur dhe nuk e ka njoftuar për ndonje parregullësi eventuale brënda ne vendin e votimeve, dhe për këtë arsëye ka raportuar se votimi ka përfunduar ne mënyre të rregullt dhe nuk ka pasur asnje parregullesi.

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit B. K., sepse me të njejtën është vërtetuar se si vëzhgues në dhomen e votimeve ku ka qenë i vendosur nuk e ka pa të akuzuarin Z. K., i akuzuari nuk ka qenë anëtarë i komisionit . Nga fillimi I votimit policija ka qenë prezente në shkollën në të cilën është zhvilluar procesi I votimit dhe tërë kohen ka qenë prezentë deri sa ka përfunduar procedura. Ne rastin konkret ne ditën e votimit nuk ka pasur asnjë parregullësi, si vëzhgues i partisë, mirëpo as nga OJQ, nuk e ka pranuar ndonjë njoftim qe ka ardhur deri tek ndonjë parregullësi gjatë procesit të votimit. Për te akuzuarin Z. K. ka shtuar se e njejtë, mirëpo ne fshatin N. ka disa persona me emer dhe mbiemer te njejtë , sikurse Z. K..

Gjykata e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit H. K., sepse me të njejtën është vërtetuar se i akuzuari Z. K. sikurse edhe te gjithë qytetaret ka ardhur për te kryer obligimin qytetar, ka votuar dhe ka dalur nga qendra e votimit. Nuk ka pranuar asnji informatë – njoftim se i akuzuari Z.K.e ka prishur rrendin ne qendren e votimit, as nuk është gjetë ndonji parregullësi nga ana e tij .

Gjykata pjesërisht e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit E. K. sepse me të njejtën është vërtetuar se në ditën e votimit me rastin kur është takuar me të akuzuarin Z. K. dhe ka biseduar aj nuk ka përdorë fjalë kërcnuese, as nuk ka egzistuar kërcnimi i

drejtëpërdrejt si me votu , apio të votohet. Me deklartën e tij poashtu ëshët vërtetuar se edhe pse rastin e ka paraqitur në polici si kërcnim vetën nuk e konsideron si palë të demtuar, apo të kërcnuar. Nga deklarata e deshmiarit gjykata nuk ka pasyr mundsinë ta kuptoj çfar kanosje ka qenë e drejtuar nga ana e të akuzuarit në drejtim të deshmitarit, përpos qe I njejt ka thekësuar ka pasur kanosje, ato kanosje nuk kanë qenë natyres serioze, por në tërsi vetën nuk e konsideron si palë të demtuar .

Gjykata nuk e ka aprovuar deklaratën e deshmitarit P. B. sepse nga deklarimi i tij nuk ka mundur të vërtetohet se ankesat kanë ardhur nga E. K. kinse i akuzuari Z. K. ka ushtruar presion ndaj votuesëve, vëzhguesëve, komisinërëve duke i orientuar votuesit për të votuar për subjektin e caktuar, kur nga deklartat e deshmitarëve që janë ndigjuar në shqyrtimin gjyqësorë, ëshët vërtetuar e kundërta se përpos personave që kanë poseduar bexhin dhe të caktuar si anëtarë të komisionit, askush tjetër nuk ka pasyr mundësin më marr pjesë dhe më qendrua nepër dhomat e votimit dhe dhoma në të cilat zhvillohet procesi zgjedhor pa e poseduar bexhat nga KQZja . Provë konkrete nuk ka egzistuar inçizimi I bisedes ëshët fshir dhe ka mbet vetëm informata nga E. i cili gjat deklarimit ka thekësuar se vetën nuk e konsideron si palë të demtuar .

Me provat e nxjerruar pa dyshim është vërtetuar se I akuzuari Z.K. ka votuar ne ditën e zgjedhejeve dikun pas orës 16:00 ne shkollën fillore ne fsh. N. dhe ka shkuar me nënën dhe gjyshen, ka qendruar ne oborrin e shkollës deri sa është bërë verifikimi i identitetit të votuesëve. Poashtu është vërtetuar se me E. K. është takuar në ditën e zgjedhejeve dhe i njejt ka shpreh paknaqësi për vëllaun e vet, sepse nuk ka qenë i punësuar edhe pse ka qenë ushtarë i UÇK-së dhe të njejtin në asnj rast nuk e ka kërcnuar, e poashtu nuk i ka orijentuar qytetarë që të votojnë për subjektin politik- PDK . Poashtu është vërtetuar se i akuzuari nuk ne asnjë moment nuk ka hyrë, apo qëndruar ne pjesën qe nuk ka qenë e lejuar. Sipas mendimit te akuzuarit kjo fletëparqitje është berë me qëllim për te dëmtuar dhe rrezikuar vendin e punës dhe krejt kjo nga gjelozia, sepse P. B. ka qenë ne TMK dhe për shkak te sjelljeve te tij jo te mira e kanë larguar nga TMK-ja, dhe ka vërtetuar se pas largimit të tij nga TMK-ja I njejt ka shprehur një urrejtje ndaj te akuzuarit dhe me vonë ka kuptuar se P. B. ka qenë i përcaktuar për subjektin politik te VV. Për këtë arsye gjykat e aprovoi deklarimin e të akuzuarit dhe i dha besim të plotë.

Gjykata e ka aprovuar edhe mbrojtjen e av .B. K. me të cilën është vërtetuar se në asnj form klienti i tij, Z.K. nuk ka ndikuar tek asnj votues qoftë se në mënyrë të kërcnimit, apo detyrimit që të votojnë për ndonji subjekt politik , meqenëse ato gjejnë mbështetje të deklaratat e deshmitarëve H. K., F. Sh., I. K., S. K., B. K., H.K., pjesërisht me deklarimin e deshmitarit E. K. si dhe tek provat tjera ta administruara në shqyrtimin gjyqësorë.

Meqenëse nuk është provuar se i akuzuari Z. K. ka kryer veprën penale të përshkuar si në aktakuzë, gjykata konform nenit 364 parg 1 nënparag 1.3 të KPPRK-së e ka liruar nga aktakuza.

Në bazë të nenit 454 parg1 të KPPRK-së është vendosë që shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetët buxhetorë.

Nga se u tha më lart është vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.115/13, të dt: 14.06.2016

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.